

**PËR KOMUNITETE
TË QËNDRUESHME
PËRMES “SHKOLLËS
QENDËR KOMUNITARE”
SI QASJE
SHUMAKTORIALE**



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

PËR KOMUNITETE
TË QËNDRUESHME

PËR KOMUNITETE
TË QËNDRUESHME
PËRMES
“SHKOLLËS
QENDËR
KOMUNITARE”
SI QASJE
SHUMAKTORIALE

KOMUNITARE

SHUMAKTORIALE

**PËR KOMUNITETE TË QËNDRUESHME
PËRMES “SHKOLLËS QENDËR KOMUNITARE”
SI QASJE SHUMAKTORIALE**

KY BOTIM ËSHTË PËRGATITUR NË KUADËR TË PROJEKTIT “ZGJERIMI I RRJETIT TË KOMUNITETEVE TË QËNDRUESHME NË SHQIPËRI PËRMES MODELIT SHUMAKTORIAL SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE”, ME MBËSHTETJEN FINANCIARE NGA AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË SHQIPËRI.

PËRMBAJTJA E KËTIJ BOTIMI ËSHTË PËRGJEGJËSI VETËM E AUTORËVE DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E DEPARTAMENTIT TË SHTETIT TË SHTETEVE TË BASHKUARA.



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



T A B E L A E P È R M B A J T J E S

SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE DHE QASJA SHUMAKTORIALE PËR KOMUNITETE TË QËNDRUESHME 5

ZBATIMI I SHKOLLËS QENDËR KOMUNITARE SI QASJE SHUMAKTORIALE VENDORE 11

SHTYLLAT KRYESORE TË ZBATIMIT TË QASJES 11

VEÇORITË E QASJES 11

KOMPONENTËT KRYESORË TË QASJES SHUMAKTORIALE SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE 13

GRUPI KËSHILLIMOR I SHKOLLËS QENDËR KOMUNITARE 13

HAPËSIRA MULTIFUNKSIONALE E SHKOLLËS NË SHËRBIM TË TË RINJVE DHE KOMUNITETIT 16

AKTIVIZIMI I TË RINJVE PËRMES NISMAVE KOMUNITARE DHE AKTIVITETEVE TË RRJETËZIMIT 19

ROLET E INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA 25

SHKOLLA 25

BASHKIA 27

POLICIA E SHTETIT 30

AKTORËT E TJERË VENDORË 33

HARTIMI I PLANIT VJETOR TË AKTIVITETEVE SHQK 37

FAZA E PARË: VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE BURIMEVE TË KOMUNITETIT TË SHKOLLËS 37

FAZA E DYTË: HARTIMI I PLANIT VJETOR TË AKTIVITETEVE SHQK 39

FAZA E TRETË: MIRATIMI I PLANIT VJETOR TË AKTIVITETEVE NGA GRUPI KËSHILLIMOR SHQK 40






VIZIONI PËR TË ARDHMEN 43

gender komunitare



SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE DHE QASJA SHUMAKTORIALE PËR KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

Shkolla Qendër Komunitare (SHQK) është një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) në vitin 2013,¹ e cila më tej u materializua në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2014-2020. Funkzioni i saj kuptohet si një qasje (lëvizje promovuese dhe zhvilluese) për ta shndërruar shkollën nga një institucion i mbyllur dhe i fokusuar vetëm në mësimdhënie dhe mësimnxënie, në një institucion ku ndërveprohet, bashkëpunohet dhe krijohet.² Për më tepër, kjo qasje synon shndërrimin e shkollës në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi,³ dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së të gjithë komunitetit përreth shkollës.⁴ Fushat e standardeve⁵ SHQK janë:

-  Sigurimi i një arsimit cilësor për çdo nxënësi
-  Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve
-  Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit
-  Vendimmarrja e përbashkët
-  Respektimi i diversitetit.



- 1 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2013). Shkollat si Qendra Komunitare www.arsimi.gov.al/shkollat-si-qendra-komunitare-2/.
- 2 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2014). Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Standardet_SHQK_2014.pdf.
- 3 Po aty, fq. 76.
- 4 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2013). Shkollat si Qendra Komunitare www.arsimi.gov.al/shkollat-si-qendra-komunitare-2/.
- 5 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2014). Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Standardet_SHQK_2014.pdf.

Fuqizimi i rrjetit të Shkollave Qendra Komunitare është një nga produktet e objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.⁶ Gjatë periudhës së ardhshme, fokusi i SHQK-së parashikohet të jetë fuqizimi i rrjetit të shkollave aktuale⁷ në nivel të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe në nivel vendi. Në këtë formë synohet të shtohen mundësitë për shkëmbim përvojash midis SHQK-ve, të shtohet bashkëpunimi i tyre me komunitetet lokale, partnerët dhe pushtetin vendor, duke i nxitur këta të fundit për përmirësim të vazhdueshëm të performancës së tyre.⁸

Duke qenë se Shkolla Qendër Komunitare është një qasje e cila mund të jetësohet në forma të ndryshme dhe me fokuse të veçanta, një model që është duke u zbatuar në Shqipëri që prej vitit 2017 është ai i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) si një qasje shumaktoriale vendore për krijimin e komuniteteve të qëndrueshme.⁹

Kjo qasje ka si qëllim forcimin e qëndrueshmërisë dhe parandalimin e çdo forme radikalizimi që çon në ekstremizëm të dhunshëm përmes masave parandaluese shumaktoriale, duke i dhënë theks të veçantë institucioneve arsimore vendore për të fuqizuar aftësitë e përhershme të të nxëniet (lifelong learning competencies).¹⁰ Qasja shumaktoriale vendore për komunitete të qëndrueshme është në përputhje dhe me një bazë të gjerë ligjore si më poshtë:



Standardet e Shkollës Qendër Komunitare 1794/2014



Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026



Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026



Ligji për Rininë 75/2019



6 Ministria e Arsimit dhe Sportit (2021). Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 www.arsimi.gov.al/vendim-nr-621-date-22-10-2021-per-miratimin-e-strategjise-kombetare-per-arsimin-2021-2026-dhe-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin-e-saj/.

7 Në Shtator 2021 numri i Shkollave Qendër Komunitare në Shqipëri u rrit në 470 shkolla. <https://www.facebook.com/kushievis/videos/559095925237462>.

8 Ministria e Arsimit dhe Sportit (2021). Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 www.arsimi.gov.al/vendim-nr-621-date-22-10-2021-per-miratimin-e-strategjise-kombetare-per-arsimin-2021-2026-dhe-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin-e-saj/.

9 Për më shumë rreth kësaj qasjeje vizitoni www.shkollaim.org/.

10 Shkolla Qendër Komunitare si qasje shumaktoriale vendore për komunitete të qëndrueshme www.shkollaim.org/.





Strategjia Kombëtare për luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2015¹¹, e cila parashikon një “evoluim” të rolit të SHQK-ve, në një mjedis të përshtatshëm për të trajtuar fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm.

Kjo qasje synon ta shndërrojë shkollën¹²:

- **NË VENDIN KU NDËRTOHEN PARTNERITETET VENDORE** midis anëtarëve të shkollës (nxënës, mësues, prindër, oficeri i sigurisë, psikologu) me institucionet vendore (bashkia, policia, zyrat vendore arsimore); organizatat lokale; komunitetet fetare; komunitetin e biznesit dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.
- **NË NJË MJEDIS NË SHËRBIM DHE NË NDËRVEPRIM ME KOMUNITETIN**, duke kontribuar në zhvillimin dhe aftësimin e të rinjve dhe anëtarëve të komunitetit; nxitjen e angazhimit qytetar në nisma lokale, në proceset vendimmarrëse dhe forcimin e demokracisë vendore; si dhe në mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e komunitetit në lidhje me sigurinë vendore.¹³

Roli i arsimit në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm,¹⁴ ka fituar rëndësi kohët e fundit mes politikëbërësve dhe profesionistëve. Trajtimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes arsimit, reflekton një ndryshim më të gjerë ndërkombëtar drejt parandalimit të terrorizmit dhe nevojës për të identifikuar mjedisin e favorshëm për ekstremistët që të përhapin ideologjitë e tyre dhe të rekrutojnë mbështetës. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse nënvizohet nga Strategjia Globale Kundër Terrorizmit e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si dhe puna e Forumit Botëror



11 Ministria e Brendshme (2015) Strategjia Kombëtare për luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2015 https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/strategjia_kombetare_per_luften_kunder_ekstrmizmit.pdf

12 Deri në momentin e publikimit të këtij botimi, qasja e zbatuar nga IDM-ja, është përqendruar vetëm tek shkollat e mesme të përgjithshme. Megjithatë, kjo qasje mund të gjejë zbatim edhe tek shkollat 9-vjeçare. Gjatë vitit 2022, IDM filloi zbatimin e kësaj qasjeje në dy shkolla 9-vjeçare në Tiranë, me financimin e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF).

13 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2019). Broshurë | Përtej kufijve të shkollës, një perspektivë për ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme www.idmalbania.org/a-community-development-perspective-to-build-resilience-may-2019/.

14 Ekstremizmi i dhunshëm nënkupton fazën përfundimtare të procesit të radikalizimit dhe i referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjikisht për të arritur objektivat politike, fetare ose ideologjike.

Kundër Terrorizmit (GCTF).¹⁵

Edhe në ditët e sotme, Shqipëria ngelet një vend i rrezikuar nga përhapja e ideologjive ekstremiste, kryesisht nëpërmjet shfrytëzimit të hapësirave virtuale.¹⁶ Si përdoruesit kryesorë të rrjeteve sociale, dhe si grup moshë më e ndjeshme ndaj rekrutimit në ekstremizëm të dhunshëm,¹⁷ të rinjtë janë më të cenusur nga moria e materialeve propagandistike, të cilat përdoren shpesh për nxitje të përçarjes fetare apo mosnjohje të shtetit demokratik.¹⁸

Në vijim të ekstremizmit të dhunshëm që u përmend më lart, të rinjtë përballen sot me një sërë sfidash të tjera të sigurisë në vend. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga 70-80 mijë përdorues të drogave në Shqipëri, janë kryesisht adoleshentët ata që bien pre e efekteve tunduese të drogës si në planin shëndetësor edhe në atë social e akademik, për shkak të brishtësisë së tyre fizike, fiziologjike, psikike, sociale dhe emocionale.¹⁹ Për më tepër, përdorimi nuk është i vetmi problem, pasi adoleshentët (15-19 vjeç) rekrutohen nga grupet e krimit të organizuar edhe për shpërndarjen e lëndëve narkotike,²⁰ por edhe për krime më të rënda.²¹ Studimet për Shqipërinë tregojnë se personat nga 14 deri në 23 vjeç janë më të ekspozuar ndaj rrezikut për t'u rekrutuar në krimin e organizuar,²² për një sërë arsyes personale dhe kushtesh familjare e socio-ekonomike.

Një tjetër sfidë me pasoja të rënda afatgjata që i paraqitet Shqipërisë, është edhe largimi i të rinjve nga Shqipëria. Sipas sondazheve, rreth 80% e studentëve shqiptarë dëshirojnë të largohen nga vendi, gati 60% e maturantëve po planifikojnë të ikin nga Shqipëria dhe 95% e të rinjve të



15 Qendra për Bashkëpunimin Botëror në Luftën kundër Terrorizmit (2013). Roli i Arsimit për të luftuar Ekstremizmin e Dhunshëm www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2013/12/Dec13_Education_Expert_Meeting_Note.pdf.

16 Shërbimi Informativ i Shtetit (2021). Raporti Vjetor 2020 www.shish.gov.al/files/Raporti%20Publik%202020.pdf.

17 CTC Sentinel (2015). Luftëtarët e huaj shqiptarë në Irak dhe Siri www.ctc.usma.edu/ethnic-albanian-foreign-fighters-in-iraq-and-syria/.

18 Shërbimi Informativ i Shtetit (2021). Raporti Vjetor 2020 www.shish.gov.al/files/Raporti%20Publik%202020.pdf.

19 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2019). Material ndihmës për mësuesit mbi edukimin e nxënësve lidhur me dëmet e abuzimit me droga dhe masat parandaluese www.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/Edukata-Antidrogë-në-Shkolla-400.pdf.

20 Reporter.al (2021). Si shfrytëzohen minorenët nga rrjetet e organizuara kriminale www.reporter.al/ciraket-e-drogës-si-shfrytëzohen-minorenët-nga-rrjetet-e-organizuara-kriminale/.

21 Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (2015). Krimi i Organizuar: Vlerësimi i riskut në Shqipëri www.osfa.al/sites/default/files/press_raporti_total_oc_0.pdf.

22 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2018). Rekomandime për të penguar dhe larguar njerëzit nga përfshirja në krimet e rënda të organizuara në Shqipëri.



larguar për studime jashtë Shqipërisë, nuk dëshirojnë të kthehen më në vendin e tyre.²³ Kjo shtysë për t'u larguar paraqet pasoja të rënda afatgjata për vendin.


Në mënyrë që t'i përgjigjet sfidave të mësipërme, por edhe sfidave të një niveli më të ulët, Shkolla Qendër Komunitare si qasje shumaktoriale vendore për komunitete të qëndrueshme,²⁴ synon të krijojë mjedisin e përshtatshëm për t'i shndërruar adoleshentët nga një grup moshë e cenueshme, në aktorë aktivë të komunitetit, të pajisur me njohuritë, aftësitë dhe mbështetjen e nevojshme për të sjellë përmirësimin e komuniteteve të tyre.



23 Top Channel (2021). Të rinjtë duan të ikin nga Shqipëria www.top-channel.tv/2021/08/19/të-rinjtë-duan-të-ikin-nga-Shqipëria-80-e-studentëve-duan-të-largohen-të-shkolluarit-jashtë-s'duan-të-kthehen/.

24 Origjina konceptuale e fjalës qëndruesë (resilience) gjendet në shkencat ekzakte, si aftësia e një materiali për të thithur shpejt sasi të mëdha energjie dhe për t'i çliruar ato përsëri pa u thyer. Kur aplikohet në shkencat politike, qëndresa mund të përkthuhet si aftësia e sistemeve politike dhe institucioneve (jo)formale të qeverisjes për t'u përshtatur me ndryshimin e kushteve politike dhe sociale duke i ruajtur strukturat e tyre të paprekura. Komunitet i qëndrueshëm i referohet një ndërhyrjeje apo angazhimi aktiv të palëve të ndryshme të interesit të komunitetit, të veshur me autoritet për forcimin e sigurisë në komunitet.

gasje
shumaktoriale



ZBATIMI I SHKOLLËS QENDËR KOMUNITARE SI QASJE SHUMAKTORIALE VENDORE

Në thelb të kësaj qasjeje qëndron ndërveprimi i institucioneve shtetërore në nivel vendor: Bashkia, Policia, dhe Shkolla (me mbështetjen e Zyrës Vendore Arsimore), si dhe bashkëpunimi i tyre me komunitetin e prindërve, qeverinë e nxënësve, të rinjtë, organizatat e shoqërisë civile, komunitetet fetare dhe komunitetin e biznesit, në përpjekje për të krijuar komunitete të qëndrueshme ndaj sfidave të ndryshme të sigurisë.

SHTYLLAT KRYESORE TË ZBATIMIT TË QASJES

- Ndërtimi i një partneriteti strategjik shumaktorial në nivel vendor, ndërmjet institucioneve vendore dhe shkollës për fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e komuniteteve të qëndrueshme.
- Krijimi i hapësirave multifunkionale dhe i mundësive për ngritjen e kapaciteteve, aftësimin e të rinjve dhe angazhimin e tyre në nisma komunitare që nxisin vullnetarizmin.
- Mbështetje për rrjetëzime dhe shkëmbime eksperiencash ndërmjet shkollave, të rinjve dhe të gjithë aktorëve të tjerë në nivel vendor.


VEÇORITË E QASJES

- **TRAJTON** shqetësimet e sigurisë në nivel vendor nëpërmjet angazhimit të të rinjve, duke i mbështetur ata të jenë aktorë aktivë të komunitetit, të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të sjellë përmirësimin e komuniteteve të tyre.


- **NXIT** ndërveprimin institucional dhe shumaktorial në nivel vendor, të strukturuar nëpërmjet “Grupit Këshillimor”, i cili është gjithëpërfshirës dhe mbliidhet në mënyrë periodike për të diskutuar zbatimin e planit vjetor të aktiviteteve, dhe për të adresuar çështjet e përbashkëta të komunitetit. Në këtë mënyrë forcohet besimi dhe marrëdhëniet ndërmjet aktorëve vendorë.
- **BASHKËRENDON** angazhimin e të gjithë aktorëve të interesit duke përcaktuar rolet konkrete dhe mënyrën e përfshirjes për aktorët kryesorë (shkolla, bashkia, policia, zyra vendore arsimore, organizatat me bazë komunitare, komunitetet fetare dhe komuniteti i biznesit). Në këtë mënyrë, jo vetëm që rritet ndikimi dhe qëndrueshmëria e angazhimeve të tyre, por edhe shmanget mbivendosja e këtyre angazhimeve, humbja e burimeve apo mohimi i përgjegjësisë.
- **MUNDËSON** adresimin e problematikave të veçanta të komunitetit nëpërmjet “nismave komunitare”, ku të gjithë aktorët kanë mundësinë të hartojnë dhe zbatojnë ndërhyrjen e nevojshme në fushën përkatëse të veprimtarive të tyre.
- **OFRON** një metodologji me tri faza për hartimin e Planit Vjetor SHQK, përfshirë edhe një strukturë model për hartimin e Planit Vjetor të Aktiviteteve.
- **FORCON** ndjenjën e ‘pronësisë vendore’ mbi aktivitetet me të rinjtë dhe shkollën, duke forcuar qëndrueshmërinë e modelit SHQK në nivel vendor.
- **PËRFSHIN** të rinjtë në proceset vendimmarrëse vendore, duke synuar kështu forcimin e demokracisë dhe përmirësimin e transparencës së institucioneve të qeverisjes vendore, si dhe rritjen e besimit publik ndaj tyre.
- **RRIT** kapacitetet e të gjithë aktorëve të shkollës (nxënësit, mësuesit, prindërit, psikologu, oficeri i sigurisë), duke i përshtatur aftësitë e tyre në shërbim të komunitetit.




KOMPONENTËT KRYESORË TË QASJES SHUMAKTORIALE SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE



GRUPI
KËSHILLIMOR
I SHKOLLËS
QENDËR
KOMUNITARE



HAPËSIRA
MULTIFUNKSIONALE
E SHKOLLËS NË
SHËRBIM TË
TË RINJVE DHE
KOMUNITETIT



AKTIVIZIMI I TË RINJVE
PËRMES NISMAVE
KOMUNITARE DHE
AKTIVITETEVE TË
RRJETËZIMIT

GRUPI KËSHILLIMOR I SHKOLLËS QENDËR KOMUNITARE

Grupi Këshillimor krijohet me përfshirjen e një sërë aktorësh në nivel vendor, të tillë si drejtorja dhe stafi i shkollës; përfaqësues të qeverisë së nxënësve; përfaqësues nga bordi i prindërve; bashkia; komisariati i policisë; zyra vendore arsimore; komunitetet fetare në nivel vendor; organizatat e shoqërisë civile; biznesi lokal; dhe aktorë të tjerë të interesit. Grupi Këshillimor përbën një nga komponentët kryesorë të kësaj qasjeje. Angazhimi i aktorëve vendorë duhet të jetë në atë nivel që të mundësojë përfaqësimin e interesave dhe mendimeve nga i gjithë komuniteti.

Anëtarët e grupit këshillimor të Shkollës Qendër Komunitare, bëhen pjesë e saj në mënyrë vullnetare, duke shprehur angazhimin dhe kontributin e tyre në arritjen e të mirave të përbashkëta për të rinjtë dhe komunitetin.



*Nga takimet e Grupeve Këshillimore në shkollat e mesme;
Haxhi Qehaj" Rrogozhinë dhe "Isa Boletini" Vorë.*

Një strukturë e ngjashme me Grupin Këshillimor parashikohet edhe në Udhëzuesin për Shkollat Qendra Komunitare,²⁵ e quajtur "ekip koordinues", ku të dyja synojnë të kenë përbërje gjithëpërfshirëse, megjithëse Grupi Këshillimor ndryshe nga ekipi koordinues, nuk është përgjegjës vetëm për procesin e vlerësimit të nevojave dhe burimeve të shkollës, por për të gjithë procesin e zbatimit të modelit SHQK.

Grupi Këshillimor shërben si pikë takimi ndërmjet institucioneve vendore, të rinjve dhe komunitetit, për të komunikuar dhe adresuar çështje të ndryshme lidhur me zhvillimin e komunitetit dhe forcimin e sigurisë dhe proceseve demokratike në shoqëri.

...

²⁵ Instituti i Zhvillimit të Arsimit (2014). Udhëzues për Shkollat Qendra Komunitare <https://docplayer.net/21659911-lzha-udhezues-per-shkollat-qendra-komunitare.html>.

Funksionet e Grupit Këshillimor SHQK:

- Rrit ndjenjën e ‘pronësisë vendore’ mbi modelin, si dhe komunikimin ndërmjet aktorëve, besimin dhe vizionin e përbashkët për Shkollën Qendër Komunitare dhe qasjen ndaj komunitetit.
- Harton planin vjetor të aktiviteteve SHQK dhe mbështet zhvillimin e tyre në bashkëpunim me shkollën dhe nxënësit.
- Ndan problematikat e lidhura me shkollën dhe adreson zgjidhjet e mundshme për krijimin e mjediseve të sigurta për të rinjtë.
- Identifikon mundësitë dhe burimet në dispozicion për vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e modelit SHQK në nivel vendor.

Suksesi i zbatimit të qasjes shumaktoriale Shkolla Qendër Komunitare për komunitete të qëndrueshme, qëndron në angazhimin e përbashkët të të gjithë aktorëve vendorë që në fillim, si anëtarë të Grupit Këshillimor dhe marrjes së përgjegjësisë për realizimin e të gjitha veprimtarive në kuadër të modelit SHQK. Shkolla merr rolin kryesor të organizatorit në këtë proces, duke garantuar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e qasjes shumaktoriale SHQK.

HAPAT PËR KRIJIMIN E GRUPIT KËSHILLIMOR:

- Identifikohen anëtarët që mund të bëhen pjesë e Grupit Këshillimor. Duhet të kihet parasysh që anëtarët të përfaqësojnë të gjithë aktorët vendorë dhe përfshirja e tyre të jetë mbi baza vullnetare dhe me dëshirë.
- Caktohet një person përgjegjës në rolin e koordinatorit për të organizuar dhe fokusuar punën e Grupit Këshillimor. Koordinator mund të jetë një mësues, një prind aktiv apo një përfaqësues komuniteti, i cili ka aftësinë të organizojë punët dhe të mbledhë grupin në vazhdimësi.
- Vendoset kontakti i parë me secilin anëtar të mundshëm, për t’i shpjeguar qëllimin e Grupit dhe marrë pëlqimin e tyre për t’u bërë pjesë e Grupit, duke shprehur angazhimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të tyre. Krijohet baza e të dhënave me kontaktet e anëtarëve, çka lehtëson komunikimin në vijim.

- Organizohet takimi i parë i Grupit Këshillimor, në mjediset e një prej institucioneve vendore, për të diskutuar mbi qëllimin e grupit, rolin dhe përgjegjësitë e çdo anëtari në mbarëvajtjen e aktiviteteve SHQK. Ky takim do të shërbejë gjithashtu për të vendosur bazat e një ndërveprimi më të ngushtë midis Shkollës, Bashkisë, Policisë dhe aktorëve të tjerë vendorë.
- Nëpërmjet Grupit Këshillimor krijohet një plan pune dhe caktohen datat e përafërta të takimeve periodike përgjatë një viti akademik. Diskutimi i aktiviteteve të shkollës me të rinjtë, dhe jo vetëm, duhet të jenë pjesë e pandarë e këtyre takimeve.

HAPËSIRA MULTIFUNKSIONALE E SHKOLLËS NË SHËRBIM TË TË RINJVE DHE KOMUNITETIT

Krijimi i një hapësire të veçantë dhe të përshtatshme brenda në shkollë, u mundëson të rinjve një mjedis tërësisht në dispozicion të tyre, ku ata mund të zhvillojnë takime apo aktivitete në shërbim të qëllimit kryesor apo aktivizimit të tyre në komunitet. Këto hapësira mund të pajisen me libra, kompjutera, mobilie e pajisje të tjera të nevojshme, për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të të rinjve.

Hapësirat shërbejnë si ambiente të hapura jo vetëm për nxënësit dhe mësuesit, por edhe për komunitetin në tërësi. Anëtarët e komunitetit inkurajohen të përdorin këtë hapësirë për të lexuar, bashkëbiseduar, zhvilluar aktivitete kulturore, artistike, sportive, apo për të marrë pjesë në kurse të ndryshme që mund të zhvillohen aty. Këto hapësira qëndrojnë të hapura gjatë pasdites në mënyrë që të shërbejnë për të gjithë komunitetin.

Krijimi i hapësirave të tilla parashikohet edhe në standardet SHQK të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit,²⁶ posaçërisht Standardi 3 (Mjedisi fizik i shkollës) në fushën e sigurimit të mirëqenies sociale, emocionale dhe shëndetësore të nxënësve.



26 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2014). Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Standardet_SHQK_2014.pdf.

MODEL POZITIV: HAPËSIRAT E KLASAVE MULTIFUNKSIONALE NË SHKOLLAT E MESME “ZIHNI MAGANI” PEQIN DHE “TOMORR SINANI” CËRRRIK, përdoren për zhvillimin e kurseve të aftësisë profesionale për komunitetin. Shkollat organizojnë kurse rrobaqepësie për vajzat dhe gratë e komunitetit. Mësuesit u angazhuan vullnetarisht në ofrimin e këtyre kurseve për komunitetin. Nëpërmjet këtyre kurseve synohet aftësimi i grave dhe vajzave të komunitetit dhe ofrimi i mundësive për të marrë një profesion dhe për t’iu përshtatur tregut të punës.

SI MUND TË KRIJOHET HAPËSIRA MULTIFUNKSIONALE:

- Diskutohet fillimisht ideja në takimin e Grupit Këshillimor. Mundësitë mund të jenë shumë më të mëdha nga sa mendohet. Nëse shkolla ofron mjedisin fizik, çfarë mund të ofrojnë institucionet dhe aktorët e tjerë vendorë në përshtatjen e hapësirës në shërbim të të rinjve dhe komunitetit?
- Mund të përdoren njohjet në komunitet. Pjesë e këtij procesi mund të bëhen edhe bizneset vendore, donatorët, organizatat e shoqërisë civile apo komuniteti i prindërve për të kontribuar në çfarëdolloj forme në përmirësimin e hapësirës multifunktionale.
- Kërkohet ndihma e nxënësve për ta modeluar hapësirën me punimet e tyre. Piktura, fotografi apo punime të tjera të vetë nxënësve, e bëjnë hapësirën më të dashur dhe më të përshtatshme për t’u përdorur.

MODEL POZITIV: KLASA MULTIFUNKSIONALE NË SHKOLLËN “HALIT BËRZESHTA” PRRENJAS, është vënë në shërbim të prindërve të kësaj shkolle, për të mësuar si të përdorin sistemin E-Albania. Mësuesit kanë dalë vullnetarë për të ndihmuar prindërit të regjistrohen në sistem dhe ta përdorin atë sa herë kanë nevojë. Në ndihmë vijnë dhe pajisjet kompjuterike që janë në shkollë.



Klasat multifunktionale të krijuara në shkollat e mesme të përgjithshme "Isa Boletini" Vorë, "Halit Bërzeshta" Prrenjas, "Arbëria" Bulqizë, "Shote Galica" Fushë-Krujë, "16 Shtatori" Shijak, të vendosura në shërbim të të rinjve dhe komunitetit

AKTIVIZIMI I TË RINJVE PËRMES NISMAVE KOMUNITARE DHE AKTIVITETEVE TË RRJETËZIMIT

Një element tjetër i rëndësishëm në mirëfunksionimin e modelit SHQK si qasje shumaktoriale vendore është mbështetja dhe zbatimi i nismave komunitare dhe aktiviteteve të rrjetëzimit ndërmjet të gjithë aktorëve vendorë. Nismat komunitare janë ide për ndërhyrje që mund të vijnë nga secili aktor i interesit në nivel vendor, në përshtatje me nevojat dhe problematikat konkrete të të rinjve dhe komunitetit. Aktivitetet duhet të bazohen në parimin e angazhimit dhe gjithëpërfshirjes së të rinjve, për të nxjerrë në pah cilësitë më të mira të tyre dhe ndihmuar zhvillimin e aftësive të veçanta të secilit nxënës.

Shkolla dhe Bashkia luajnë rolin kryesor në realizimin e këtyre aktiviteteve. Nga njëra anë, Shkolla, me përkrahjen e Zyrës Vendore Arsimore, nxit përfshirjen e nxënësve në veprimtari të ndryshme, duke kultivuar tek ata frymën e angazhimit, vullnetarizmit dhe përgjegjshmërisë. Nga ana tjetër, Bashkia ka mundësi të mbështesë me fonde aktivizimin e të rinjve në nisma komunitare, por edhe të mundësojë angazhimin e tyre në proceset vendimmarrëse të qeverisjes vendore. Angazhimi i përbashkët dhe ndarja e përgjegjësisë ndërmjet këtyre aktorëve, i shtojnë vlerën realizimit të nismave, duke fuqizuar të rinjtë dhe duke forcuar zërin e tyre në adresimin e nevojave të komunitetit.

NISMAT VENDORE mund të hartohen nga vetë të rinjtë, prindërit, stafi i shkollës (mësues, oficer sigurie, psikolog), njësitë e qeverisjes vendore, organizatat rinore, aktivistët e shoqërisë civile apo aktorët e tjerë të interesit. Por, secila nismë duhet të ketë në fokus angazhimin konkret të të rinjve për të adresuar shqetësimet e sigurisë në komunitetet përkatëse.

Nismat novatore dhe konkrete për kontekstin vendor mund të kontribuojnë në:

- Zhvillimin e Planit Vjetor të Aktiviteteve SHQK.
- Zbatimin e qasjes shumaktoriale për komunitete të qëndrueshme në adresimin e çështjeve të sigurisë vendore.
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore, agjencive ligjzbatuese, dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve dhe komunitetit në proceset e vendimmarrjes vendore.
- Ngritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe zhvillimin e mendimit kritik.
- Rritjen e cilësisë së aktiviteteve të edukimit joformal, vullnetarizmit dhe praktikave të punës për të rinjtë.
- Ofrimin e mbështetjes psiko-fizike nëpërmjet kulturës, artit dhe sportit për të rinjtë e cenueshëm nga fenomenet negative.
- Zhvillimin e programeve sportive dhe shkëmbimeve kulturore midis të rinjve dhe përfaqësuesve të institucioneve vendore, për të promovuar përfshirjen sociale dhe bashkëjetesën.

DISA NGA AKTIVITETET QË MUND TË ZHVILLOHEN PËRMES NISMAVE JANË:

- Aktivizimi i të rinjve për të nxitur transparencën dhe konsultimin publik nga institucionet vendimmarrëse vendore;
- Aktivitete ndërgjegjësimi ndaj fenomeneve negative në shoqëri – bullizmi, diskriminimi social, paragjykimet dhe gjuha e urrejtjes, dhuna dhe elementet e ekstremizmit të dhunshëm;
- Zhvillimi i aftësive profesionale të të rinjve në fusha të veçanta, si zdrukthëtari, rrobaqepësi, qëndistari, teknologji informacioni etj.
- Aktivitete sensibilizuese për sigurinë rrugore, kujdesin për jetën dhe menaxhimin e situatave problematike.
- Krijimi i grupeve vullnetare të të rinjve që adresojnë çështje të ndryshme sociale në komunitet.
- Aktivitete për promovojnë diversitetin, bashkëjetesën dhe harmoninë ndërfaqetare.
- Aktivitete artistike, vizita dhe shkëmbime kulturore për të njohur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore.

- Aktivitete sportive dhe kampionate ndërmjet shkollave në nivel ZVA-je, të rinjve të komunitetit, përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe aktorëve të tjerë.
- Bashkëpunim midis shkollave dhe sektorit privat për të ndihmuar në zhvillimin profesional të të rinjve, përmes mentorimit dhe praktikave vullnetare të punësimit.

RRJETËZIMI i shkollave nënkupton hartimin dhe zbatimin e nismave që synojnë bashkëpunimin e shkollave të ndryshme në nivel bashkie apo edhe më gjerë. Rrjeti i shkollave komunitare në një zonë të caktuar, parashikohet edhe në standardet SHQK, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit,²⁷ ku rrjetëzimi cilësohet si vizioni për shndërrimin e plotë të shkollave si qendra komunitare. Për më tepër, fuqizimi i rrjetit të Shkollave Qendra Komunitare parashikohet edhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026,²⁸ ku theksohet se fokusi gjatë zbatimit të kësaj strategjie do të jetë në fuqizimin e rrjetit të SHQK-ve në nivel të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe në nivel vendi. Në këtë formë synohet që të shtohen mundësitë për shkëmbim të përvojave midis shkollave, bashkëpunim me komunitetet lokale, pushtetin vendor dhe partnerët e tjerë, duke i nxitur ato për përmirësim të vazhdueshëm të performancës.²⁹

MODEL POZITIV: RRJETËZIMI MES SHKOLLËS SË MESME “FUAT BABANI” BILISHT DHE SHKOLLËS SË MESME “HALIT BËRZESHTA” PRRENJAS në një nismë ndërgjegjësuere për Tetorin Rozë në qytetin e Bilishtit.

Objektivat e kësaj nisme ishin:

- Rrjetëzimi i shkollave dhe shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet të rinjve, përmes nismave të përbashkëta vullnetare.



27 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2014). Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Standardet_SHQK_2014.pdf.

28 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2021). Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 www.arsimi.gov.al/vendim-nr-621-date-22-10-2021-per-miratimin-e-strategjise-kombetare-per-arsimin-2021-2026-dhe-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin-e-saj/.

29 Po aty.

- Fuqizimi i të rinjve dhe angazhimi i tyre në fushata ndërgjegjësuere në komunitet.
- Rritja e ndërveprimit të të rinjve me institucionet vendore dhe aktorë të tjerë.
- Informimin e shoqërisë rreth sëmundjes së kancerit të gjirit dhe kujdesit ndaj vetes.



Fushatë ndërgjegjësimi për Tetorin Rozë mes shkollave të mesme "Halit Bërzeshta" Prrenjas dhe "Fuat Babani" Bilisht, me përfshirjen e Pushtetit Vendor, Komisarariatit të Policisë dhe Komunitetit

Rrjetëzimi është veçanërisht i vlefshëm për të angazhuar shkolla që nuk janë ende qendra komunitare, përpos atyre që janë, pasi në këtë formë nxitet shkëmbimi i përvojave dhe ndarja e njohurive midis të rinjve. Në këtë mënyrë, shkollat kombinojnë përpjekjet për të paraqitur ide aktivitete të fokusuara veçanërisht në rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes tyre, të tilla si: binjakëzimi i shkollave, fushata ndërgjegjësimi, nisma të përbashkëta të prindërve, kampionate sportive, konkurse artistike, apo aktivitete kulturore.

Gjithashtu, përmes rrjetëzimeve shkollat zhvillojnë kapacitetet e tyre për të aplikuar në kuadër të nismave të ndryshme, në nivel kombëtar apo rajonal. Në mënyrë që shkollat të bëhen konkurrenca të forta në këtë drejtim, është e rëndësishme që ato të rrisin aftësitë e stafit akademik për të përgatitur projekt-propozime dhe zbatuar aktivitete që sjellin komunitetin më pranë shkollës.

MODEL POZITIV: RRJETËZIMI MES SHKOLLËS SË MESME “TOMORR SINANI” CËRRIK DHE SHKOLLËS SË MESME “MUSTAFA KEMAL ATATURK” PAJOVË në një nismë të përbashkët ndërgjegjësimi të komuniteteve vulnerabël në të dy qytetet kundër dhunës në familje, dhunës ndaj gruas dhe fenomenit të bullizmit.

Objektivat e kësaj nisme ishin:

- Përfshirja e të rinjve në nisma ndërgjegjësuese mbi problematikat e shoqërisë, sidomos ato që kanë në fokus sjelljet ekstremiste dhe pasojat e tyre në shoqëri.
- Rritja e ndërveprimit dhe shkëmbimit mes të rinjve nga qytete të ndryshme, si dhe mes tyre e komunitetit.
- Rrjetëzimi i shkollave të mesme dhe rritja e ndërveprimit me institucionet vendore dhe aktorë të tjerë vendorë.



Fushatë ndërgjegjësimi kundër Dhunës dhe Bullizmit, ndërmarrë nga shkollat e mesme "Tomor Sinani" Çërrik dhe "Mustafa Kemal Atatürk" Pajovë, Peqin

ROLET E INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA

SHKOLLA

Shkolla është në qendër të qasjes shumaktoriale për krijimin e komuniteteve të qëndrueshme, si institucioni që mund të koordinojë më së miri të gjithë aktorët e tjerë në nivel vendor, me fokus parësor të rinjtë. Shkolla është vendi ku të rinjtë edukohen për të ardhmen, jo vetëm duke u pajisur me dijet shkollore, por mbi të gjitha duke u formësuar me vlerat shoqërore e demokratike. Dhe pikërisht, përmes shkollës, në bashkëpunim me të gjithë aktorët vendorë, mund të punohet për të ndikuar tek të rinjtë dhe për t'i fuqizuar ata me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përballuar sfidat e së ardhmes.

Roli i shkollës në qëndrueshmërinë e qasjes shumaktoriale SHQK:

- a) Shkolla është institucioni **që ndërlidh institucionet e tjera në nivel vendor** për të vepruar bashkërisht në mënyrë proaktive, për të marrë përgjegjësi dhe ndërmarrë veprime në përballimin e sfidave të sigurisë në nivel vendor. Duke u vendosur në qendër të qasjes shumaktoriale SHQK, shkolla e kthen vëmendjen e institucioneve vendore dhe aktorëve të tjerë drejt nevojave të saj, për realizimin jo vetëm të procesit mësimor, por edhe të aktiviteteve me të rinjtë.
- b) Krijon **hapësira dhe mundësi për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësimin e të rinjve dhe komunitetit**, përmes edukimit joformal dhe trajnimeve të ndryshme. Zhvillimi i aftësive të të rinjve përtej procesit mësimor, duhet të bëhet pjesë e pandarë në edukimin e tyre. Përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme në shkollë mund të rriten aftësitë e nxënësve dhe të nxitet mendimi kritik, duke zhvilluar një gjykim të shëndoshë tek të rinjtë për të bërë zgjedhjet e duhura për të ardhmen.

- c) Nxit tek të rinjtë **ndjenjën e vullnetarizmit dhe të aktivizimit** në komunitet. Motivimi i të rinjve për t'u angazhuar në veprimtari vullnetare në komunitet, i bën ata pjesë të nevojave dhe shqetësimeve të komunitetit. Kjo zgjon tek të rinjtë dëshirën për t'i dhënë zgjidhje problemeve, duke kontribuar në zhvillimin e shoqërisë. Duke i angazhuar të rinjtë në nisma komunitare, forcohet ndjenja e qytetarisë dhe vlerave demokratike në shoqëri. Një element i rëndësishëm në fuqizimin e të rinjve është ofrimi i mundësisë që të hartojnë dhe zbatojnë vetë projekt-ide me fokus angazhimin në komunitet dhe adresimin e fenomeneve të ndryshme të shoqërisë. Njëkohësisht, kjo mundëson gjithëpërfshirjen mes të rinjve, sipas tematikave ku ata e gjejnë veten më mirë të përfaqësuar.
- d) Rrit **qasjen e prindërve ndaj shkollës dhe të rinjve**, përmes përfshirjes në veprimtari të përbashkëta. Angazhimi i prindërve në shkollë është kryesisht i dobët në vendin tonë. Kjo vjen për shkak të kushteve social-ekonomike të shumicës së familjeve shqiptare, por dhe mentalitetit të mbartur tek prindërit që duhet të jenë të pranishëm në shkollë vetëm kur bëhet fjalë për ecurinë në mësimet e fëmijëve të tyre.

PËRFITIMET E MUNDSHME PËR PRINDËRIT QË PËRFSHIHEN NË QASJEN SHUMAKTORIALE VENDORE SHQK:

- Prindërit bëhen pjesë e proceseve të zhvillimit të shkollës, duke vlerësuar më mirë nevojat dhe ofruar mbështetje.
- Forcohen lidhjet me aktorët vendorë, burimet dhe shërbimet e ofruara, duke ndikuar në mirëqenien e tyre.
- Rritet përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse dhe organizative në nivel komunitar.
- Përmes trajnimeve të ndryshme, prindërit zhvillojnë aftësitë për të kuptuar fëmijët dhe ndihmuar ata jo vetëm në proceset edukative por dhe më gjerë.
- Rritet vetëvlerësimi i prindërve, njëkohësisht dhe vlerësimi për përpjekjet e fëmijëve dhe të mësuesve.
- Forcohet kohezioni social përmes njohjeve dhe mundësive të reja të krijuara.



MODEL POZITIV: ANGAZHIMI I DREJTUESIT TË BORDIT TË PRINDËRVE TË SHKOLLËS "ISA BOLETINI" VORË në ideimin dhe realizimin e kampionatit të volejbollit ndërmjet tri shkollave të mesme të Vorës.

Qëllimi i kësaj nisme ishte aktivizimi i të rinjve në aktivitete të përbashkëta sportive, për të nxitur socializimin dhe dashurinë për sportin. Ky kampionat ishte dhe një shtysë për Bashkinë e Vorës për të reaguar për më shumë aktivitete dhe hapësira sportive për të rinjtë.

BASHKIA

Si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, angazhimi i bashkisë në modelin SHQK si qasje shumaktoriale vendore, është e domosdoshme për të siguruar "pronësinë vendore" dhe qëndrueshmërinë e këtij modeli.

Përmes këtij angazhimi, bashkia:

- Rrit ndërveprimin me të rinjtë dhe anëtarët e tjerë të komunitetit.
- Njihet dhe adreson drejtpërdrejt shqetësimet e tyre.
- Investon tek prioritetet e të rinjve.
- Ofron mundësi për angazhimin e të rinjve në vendimmarrjen vendore.
- Forcon demokracinë e brendshme.
- Harmonizon dhe shmang mbivendosjen e programeve të ndryshme në nivel vendor.

Roli i bashkisë gjen mbështetje tek Ligji për Rininë Nr. 75/2019,³⁰ i cili ngarkon bashkitë me përgjegjësinë për të hartuar dhe zbatuar politika vendore për rininë (neni 7); si dhe në Ligjin

...

30 Ligji për Rininë 75/2019 <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/11/04/75/bed73fae-2777-483f-a130-25277479c5d2;q=Ligji%20per%20rinine>

për Vetëqeverisjen Vendore Nr. 139/2015,³¹ i cili përcakton specifikisht funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës publike lidhur me ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar (neni 23); konsultimin publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore (neni 16); seancat e këshillimeve me bashkësinë (neni 18); si dhe të drejtën e iniciativës qytetare (neni 20).

MODEL POZITIV NË BASHKINË KAMËZ: LANÇIMI I NJË PROGRAMI PRAKTIKE PËR NXËNËSIT E GJIMNAZIT

Katër nxënës nga gjimnazi "Ibrahim Rugova" në Kamëz u bënë pjesë e programit të praktikës. Përgjatë një muaji, nxënësit u angazhuan me kohë të pjesshme në një departament të caktuar të Bashkisë. Përmes kësaj eksperience, të rinjtë u njohën me strukturën e institucionit dhe me përgjegjësitë e secilit departament, duke vendosur një komunikim të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e pushtetit vendor. Iniciativa të tilla sjellin zërin e të rinjve më pranë vendimmarrjes dhe i bëjnë të rinjtë të ndihen pjesë e komunitetit të tyre.

Bashkia mund të kontribuojë në qasjen shumaktoriale SHQK përmes:

- Promovimit dhe mbështetjes financiare të nismave komunitare dhe qëndrueshmërisë së tyre.
- Investimit në infrastrukturën e shkollave dhe krijimin e hapësirave multifunkionale në shkolla.
- Investimeve për identifikimin dhe promovimin e talenteve rinore.
- Informimit të vazhdueshëm të të rinjve rreth aktiviteteve të bashkisë që kanë në fokus të rinjtë.

...

31 Ligji për Vetëqeverisjen Vendore 139/2015 https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/12/17/139/2b2336ff-7ced-4905-a099-268e5e5c7dc6;q=Ligj_nr.139-2015

- Nxitjes dhe ofrimit të ndihmës ndaj shkollave për të rritur ndërveprimin dhe për të ofruar shërbime e programe që i vijnë në ndihmë komunitetit, shoqërisë civile dhe pushtetit vendor.
- Mbështetjes së koordinatorëve SHQK për realizimin e aktiviteteve në territorin e bashkisë.
- Pjesëmarrjes aktive, përmes përfaqësuesve të saj, në takimet e Grupit Këshillimor SHQK, duke u angazhuar dhe në hartimin e planit të aktiviteteve të shkollës.
- Lehtësimit të komunikimit me bizneset e zonës, për të ofruar praktika dhe mundësi punësimi për të rinjtë.
- Krijimit të hapësirave të përshtatshme për përfshirjen e të rinjve në programet e praktikave të punës në institucionet vendore.
- Ofrimit të mundësive për vendimmarrje gjithëpërfshirëse përmes angazhimit konstruktiv të familjes, komunitetit, shkollës dhe institucioneve sociale; si dhe inkurajimit të të rinjve për të adresuar çështjet sociale dhe shqetësimet rinore.



Bashkia Bulqizë bën pjesë të rinjtë e qytetit në proceset vendimmarrëse në nivel vendor

POLICIA E SHTETIT

Përfshirja e Policisë së Shtetit në qasjen shumaktoriale vendore SHQK është plotësuese e vetë rolit të policisë në komunitet. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, punonjësit e policisë do të jenë jo vetëm më të informuar për problematikat e komunitetit, sidomos të të rinjve, por në mënyrë të veçantë do të rrisin ndërveprimin me ta. Këto role për punonjësit e Policisë së Shtetit parashikohen tek Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026, ku një nga rezultatet e pritshme është rritja e ndërveprimit për parandalimin dhe adresimin e problematikave në shkollat e arsimit parauniversitar me ndihmën e mësuesit, drejtuesit të shkollës, policisë dhe komunitetit nëpërmjet mekanizmit Shkolla Qendër Komunitare.³² Angazhimi i Policisë së Shtetit në modelin SHQK përmendet edhe në Udhëzuesin për Shkollat Qendra Komunitare.³³ Për më tepër, bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me rininë, parashikohet edhe në Manualin për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.³⁴

Angazhimi në këtë qasje nuk do të jetë një barrë, por lehtësim i punës së policisë. Kohët e fundit, siguria në komunitet përshkruhet si përgjegjësi e të gjithë aktorëve përgjegjës në këtë fushë, e cila kërkon një gjithëpërfshirje të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, që kanë detyrimin ligjor për garantimin e sigurisë në komunitet.³⁵ Në këtë mënyrë, siguria publike nuk do të jetë më kompetencë vetëm e Policisë së Shtetit, duke shfrytëzuar qasjen e deritanishme vertikale në garantimin e rendit dhe sigurisë në vend. Ky koncept, tashmë, do të jetë më demokratik dhe në rrafshin horizontal, duke bërë bashkë të gjithë aktorët institucionalë, qendrorë dhe vendorë, institucionet ligjzbatuese, Policinë e Shtetit, qytetarët dhe komunitetin, institucionet e tjera joqeveritare, bizneset, institucionet fetare dhe mediat, që të krijohet një kulturë e re e sigurisë publike. Në të njëjtën linjë, qëndron edhe angazhimi i policisë në modelin SHQK si qasje shumaktoriale për komunitete të qëndrueshme, ku punonjësit e policisë do të ndërveprojnë me të gjithë aktorët vendorë për të përmirësuar rolin e policisë në komunitet, rritur besimin dhe nxitur mbështetjen e komunitetit.



32 Strategjia e re Ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit 2021 – 2023.

33 Instituti i Zhvillimit të Arsimit (2014). Udhëzues për Shkollat Qendra Komunitare <https://docplayer.net/21659911-lzha-udhezues-per-shkollat-qendra-komunitare.html>.

34 Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1219, datë 07.12.2021. Manual për Parandalimin e Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, Rehabilitimi dhe Riintegrimi i të kthyerve nga zonat e konfliktit nëpërmjet Policimit në Komunitet.

35 Po aty.

Përmes një qëndrimi proaktiv, punonjësit e Policisë së Shtetit bëhen agjentë ndryshimi duke ndikuar në rritjen e kulturës së bashkëpunimit, informimit dhe ndërveprimit në komunitet, në përpjekje për të garantuar sigurinë publike dhe krijuar komunitete të qëndrueshme ndaj fenomeneve negative.

Policia vendore mund të kontribuojë në modelin SHQK përmes:

- Autorizimit të përfaqësuesve të saj për të marrë pjesë në takimet e Grupit Këshillimor, përfshirë dhe hartimin e Planit Vjetor të Aktiviteteve të shkollës.
- Pjesëmarrjes në aktivitete me të rinjtë dhe prindërit, për të rritur ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin midis tyre në fushën e sigurisë publike.
- Bashkëpunimit me koordinatorët SHQK për të zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në komunitet, në bashkëpunim me të rinjtë.
- Pjesëmarrjes në aktivitetet sportive, artistike dhe rinore, si instrumente për të rritur ndërveprimin e vazhdueshëm dhe nxitjen e mënyrave paqësore të shprehjes.
- Hartimit dhe mbështetjes së nismave të ndryshme rrjetëzuese mes të rinjve, veçanërisht ato për shkëmbimin e përvojave dhe rritjen e njohurive.
- Përfshirjes së të rinjve në aktivitetet ndërgjegjësuese të policisë, në veçanti për aktivitete me ndikim të shpërpjesëtuar tek të rinjtë, si p.sh: ndalimet dhe kontrollet. Të tilla nisma ofrojnë një mundësi për të rinjtë dhe policinë, për t'u njohur më mirë dhe për të shkëmbyer mendime mbi mënyrat se si të rinjtë mund të ndikohen nga disa prej masave policore.
- Hartimit të programeve edukative për të rinjtë, të cilët mund të jenë të interesuar për t'iu bashkuar radhëve të policisë.

MODEL POZITIV: KOMISARIATI I POLICISË BULQIZË

Të njohur me problematikat e qytetit, përfaqësuesit e policisë në Bulqizë bashkëpunuan me gjimnazin "Arbëria" për të zhvilluar një fushatë sensibilizuese në qytet. Nxënësit vizituan ambientet e Komisarariatit të Policisë, u informuan rreth dëmeve nga përdorimi i alkoolit, duhanit, drogës, si dhe rreth sigurisë në internet. Bashkë me punonjësit e policisë, nxënësit dolën në qytet për të dhënë mesazhe ndërgjegjëse dhe shpërndarë broshura tek qytetarët.



Aktiviteti i përbashkët i Komisarariatit të Policisë Bulqizë me nxënësit e shkollës së mesme "Arbëria" Bulqizë

AKTORËT E TJERË VENDORË

Zbatimi i modelit SHQK sipas qasjes shumaktoriale vendore synon të sjellë një frymë të re bashkëpunimi. Përtej aktorëve shtetërorë që u përmendën më lart, ky model kërkon edhe angazhimin e aktorëve joshitetërorë, të tillë si organizatat me bazë komunitare, komunitetet fetare, komunitetin e biznesit dhe aktivistët lokalë. Qasja shumaktoriale synon të forcojë qëndresën e komunitetit duke i shtyrë drejt bashkëpunimit aktorët shtetërorë me aktorët joshitetërorë, duke rritur kapacitetet e tyre, duke i mbështetur ata për të hartuar dhe organizuar aktivitete dhe duke nxitur investimin e ndërsjellë. Të gjithë këta aktorë kanë rol të rëndësishëm në funksionimin e kësaj qasjeje.

ORGANIZATAT ME BAZË KOMUNITARE

Organizatrat me bazë komunitare, të tilla si OSHC-të dhe grupimet rinore, angazhohen në jetën publike dhe synojnë të avancojnë vlerat dhe objektivat e përbashkëta të komunitetit. Këto organizata janë me rëndësi në zbatimin e modelit SHQK sipas qasjes shumaktoriale vendore për shkak të ekspertizës dhe kontributit të tyre në punën me komunitetet dhe për komunitetet. Ato mund të organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese në fusha të ndryshme me përparësi për komunitetin, duke bashkëpunuar me aktivistët lokalë dhe duke angazhuar të rinjtë të ndërmarrin nisma që kanë në fokus aftësimin e tyre dhe ndërveprimin me komunitetin. Gjithashtu, OSHC-të kanë më shumë hapësira për të financuar nismat e hartuara nga aktorët e shkollës nëpërmjet projekteve të tyre. Në këtë mënyrë, organizatat do mund të kanalizojnë energjitë e të rinjve në kauza të vlefshme për komunitetin.

KOMUNITETI FETAR

Në vijim të përhapjes së formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm, veçanërisht ato fetare, roli i komunitetit fetar merr një rëndësi më të madhe. Udhëheqësit fetarë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e veprimeve kundër ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Unike për ta është fuqia e tyre teologjike dhe roli i tyre në hartimin e mesazheve kundër propagandës ekstremiste të dhunshme. Duke qenë se hapat e parë në fe konsiderohen

shumë delikate, veçanërisht për të rinjtë, sugjerohet si tepër e rëndësishme që një proces i tillë të zhvillohet në institucione të njohura zyrtarisht dhe nën mentorimin e klerikëve fetarë të përgatitur teologjikisht.

Nëpërmjet angazhimit në modelin SHQK sipas qasjes shumaktoriale për komunitete të qëndrueshme, përfaqësues të besimeve të ndryshme fetare në komunitet mund të zhvillojnë dialog të përbashkët me nxënësit. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, nga njëra anë promovohet fryma e harmonisë ndërfaqetare, bashkëjetesës kulturore dhe historisë së fesë; dhe nga ana tjetër, të rinjtë e interesuar në fe orientohen drejt objekteve zyrtare dhe përfaqësuesve të kualifikuar fetarë.

Kjo ndihmon në shmangien e keqpërdorimit të dashamirësisë fetare të të rinjve nga individët, grupet apo ligjërimi ekstremist.

MODEL POZITIV: TË RINJTË E PEQINIT VIZITOJNË XHAMINË HISTORIKE TË QYTETIT

Të rinjtë e gjimnazit "Zihni Magani" Peqin zhvilluam një aktivitet për njohjen e vlerave kulturore në zonë. Ata vizituan xhaminë "Abdurrahman Pasha" dhe Kullën e Sahatit në Peqin, të cilat datojnë në shek. XVII dhe kanë vlera historike për zonën. Të rinjtë u mikpritën nga myftiu i qytetit, i cili u foli për historikun e xhamisë dhe rëndësinë e saj për qytetin e Peqinit.



Nxënësit e shkollës së mesme "Zihni Magani" Peqin, të shoqëruar nga Myftiu, vizitojnë xhaminë historike të qytetit

KOMUNITETI VENDOR I BIZNESIT

Bizneset përbëjnë një hallkë kyçe të zhvillimit ekonomik në komunitet, dhe mirëqenia ekonomike ndikon drejtpërdrejt në qëndresën e komunitetit. Për këtë, është me rëndësi përfshirja e komunitetit të biznesit në qasjen shumaktoriale SHQK. Fokus i veçantë nevojitet t'i kushtohet përfshirjes së bizneseve të reja (start-ups) dhe bizneseve të udhëhequra nga të rinjtë, në mënyrë që të ndahet përvoja e tyre dhe të rinjtë të motivohen të eksplorojnë mënyra të reja punësimi, si puna e pavarur (freelance) apo hapja e bizneseve të tyre. Ngjashëm me OSHC-të, edhe bizneset vendore cilësohen në standardet SHQK të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit,³⁶ si aktorë që përfshihen në shndërrimin e shkollave si qendra komunitare.

Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit mund të përfshihen në aktivitete që synojnë ngritjen e kapaciteteve të të rinjve apo duke zhvilluar seanca konsultuese për të ndihmuar të rinjtë t'i përshtatin aftësitë dhe kualifikimet e tyre me nevojat e bizneseve. Gjithashtu, bizneset mund të ofrojnë programe mentorimi, kurse, apo praktika pune për të rinjtë, por mund të financojnë edhe nismat komunitare që hartohen nga të rinjtë.

Koordinatorët SHQK, nevojitet të nxisin komunitetin e biznesit të marrë pjesë në hartimin e planit vjetor të aktiviteteve, tek i cili mund të detajohet edhe mënyra dhe format e përfshirjes së bizneseve vendore.

MODEL POZITIV: TË RINJTË E SHIJAKUT VIZITOJNË AGROTURIZMIN GJEPALI

Të rinjtë e gjimnazit "16 Shtatori" Shijak zhvilluan një vizitë pranë kompleksit Agroturizëm Gjepali. Z. Fundim Gjepali ndau me të rinjtë historinë e tij të suksesit në sipërmarrje dhe përfitimet e këtij biznesi për komunitetin, ku të gjithë produktet që përdoren në kompleks blihen nga fermerët e zonës. Z. Gjepali, në një bisedim të lirë me të rinjtë, u ofroi atyre mundësi punësimi në kompleksin e tij, si dhe zhvillimin e praktikave në fushën e shërbimit.



36 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2014). Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Standardet_SHQK_2014.pdf.



Nxënësit e gjimnazit "16 Shtatori" Shijak në mjediset e Agroturizëm Gjepali

HARTIMI I PLANIT VJETOR TË AKTIVITETEVE SHQK

Zbatimi i modelit SHQK sipas qasjes shumaktoriale për komunitete të qëndrueshme mbështetet në ndërveprimin midis institucioneve arsimore vendore, bashkisë dhe Policisë së Shtetit, si dhe në bashkëpunimin e tyre me komunitetin e prindërve, nxënësit, të rinjtë, organizatat e shoqërisë civile dhe të gjithë aktorët e tjerë në nivel vendor.

Hartimi i planit të aktiviteteve SHQK sipas kësaj qasjeje synon bashkëpunimin e gjerë mes të gjithë aktorëve të përfshirë, ku secili mund të ofrojë pikëpamjet e tij. Pavarësisht se mënyra e hartimit të planit vjetor të aktiviteteve është e njëjtë, planet e hartuara nga secila shkollë janë autentike, ku secila shkollë përcakton prioritetet për vitin e ardhshëm shkollor, reflekton problematikat përkatëse, dhe burimet që ajo ka në dispozicion.

FAZA E PARË: VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE BURIMEVE TË KOMUNITETIT TË SHKOLLËS

Gjatë fazës së parë të zbatimit, zhvillohet vlerësimi i nevojave, burimeve dhe kapaciteteve të aktorëve vendorë për të zbatuar modelin "Shkolla Qendër Komunitare".³⁷ Ai mund të shërbejë si dokument vlerësues i gjendjes fillestare dhe më pas të monitorohet ndryshimi pas një periudhe të caktuar. Ky vlerësim mund të zhvillohet nëpërmjet tri mënyrave të ndryshme:

- Anketave

...

37 Instituti i Zhvillimit të Arsimit (2014). Udhëzues për Shkollat Qendra Komunitare <https://docplayer.net/21659911-lzha-udhezues-per-shkollat-qendra-komunitare.html>.

- Grupeve të diskutimit
- Intervistave

Në mënyrë që të mundësohet përftimi i pikëpamjeve të grupeve të ndryshme pa u ndikuar nga njëri-tjetri, sugjerohet që, cilado qoftë mënyra e zhvillimit të vlerësimit, ajo duhet të zhvillohet në mënyrë të ndarë për secilin grup:

- Nxënësit e shkollës
- Stafin pedagogjik, psikologun dhe oficerin e sigurisë
- Bordin e prindërve

Pikat e diskutimit gjatë vlerësimit të nevojave dhe burimeve të shkollës bazohen në katër (nga pesë) standardet dhe objektivat "Shkolla Qendër Komunitare" të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe konkretisht:

- Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve
- Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit
- Vendimmarrja e përbashkët
- Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit

Standardi i përcaktuar nga MAS "Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës" nuk përfshihet në modelin SHQK sipas qasjes shumaktoriale për komunitete të qëndrueshme, sepse ajo shihet si kompetencë e vetë institucioneve arsimore, megjithëse ekziston një lidhje e ndërsjellë ndërmjet të gjitha standardeve.

Bazuar në të dhënat e përfuara nëpërmjet vlerësimit të nevojave dhe burimeve në dispozicion, hartohen aktivitetet SHQK për atë vit shkollor.

FAZA E DYTË: HARTIMI I PLANIT VJETOR TË AKTIVITETEVE SHQK

Plani Vjetor i Aktiviteteve SHQK sipas qasjes shumaktoriale vendore për komunitete të qëndrueshme, synon të integrojë në një dokument të vetëm qasjet që kanë në thelb bashkëpunimin ndërinstitucional dhe lidhjen e ngushtë me komunitetin, siç është qasja e “Policimit në komunitet” apo përgjegjësitë dhe frymën bashkëpunuese që duhet të krijojnë institucionet e qeverisjes vendore me qytetarët, me qëllim nxitjen e demokracisë vendore. Duke qenë se Plani Vjetor SHQK është një i vetëm, pjesë e tij bëhen të gjitha veprimtaritë që shkolla i ka identifikuar të nevojshme në përmbushjen e fushave apo treguesve të standardeve SHQK.

Plani është dokumenti i cili orienton dhe udhëheq zbatimin e aktiviteteve, bazuar në nevojat e identifikuara gjatë realizimit të vlerësimit në shkollë. Aktivitetet hartohen të ndara sipas katër standardeve të përmendura më sipër. Në hartimin e planit, vëmendje duhet t’i kushtohet identifikimit të saktë të institucioneve përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve dhe burimeve në dispozicion apo mundësive të jashtme për mbështetje. Gjithashtu, është e rëndësishme edhe në këtë fazë, që të merret mendimi i nxënësve dhe stafit të shkollës mbi aktivitetet e mundshme që do të realizohen përgjatë vitit akademik.

Të dhënat e mbledhura nga vlerësimi i nevojave dhe burimeve, si dhe aktivitetet e identifikuara përmbledhen në një dokument të veçantë nga koordinatorët SHQK. Procesi i hartimit të planit vjetor parashikohet edhe në Udhëzuesin Shkolla Qendër Komunitare.³⁸ Këtu sugjerohet ndarja e këtij procesi në dy faza; hartimi fillestar i planit dhe më pas miratimi përfundimtar i tij gjatë takimit të radhës së Grupit Këshillimor. Struktura e sugjeruar e planit është si vijon, duke përfshirë ndër të tjera edhe institucionin përgjegjës për zbatimin e veprimtarisë specifike, burimet dhe treguesin matës.



38 Instituti i Zhvillimit të Arsimit (2014). Udhëzues për Shkollat Qendra Komunitare <https://docplayer.net/21659911-lzha-udhezues-per-shkollat-qendra-komunitare.html>.

Strukturë model për hartimin e Planit Vjetor të Aktiviteteve SHQK

STANDARDI 1: SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE					
Objektiva specifike:					
<ul style="list-style-type: none"> ● ● 					
VEPRIMTARIA	AKTORËT E PËRFSHIRË	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	BURIMET	TREGUESI MATËS	PERIUDHA E ZBATIMIT
1.	● ●	● ●	● ●	● ●	● ●
2.	● ●	● ●	● ●	● ●	● ●

Niveli i zbatimit dhe monitorimi i secilit prej aktiviteteve dhe i përmbushjes së objektivave specifike për secilin standard deri në fund të vitit akademik, do të kryhet nëpërmjet treguesve të mirëpërcaktuar për secilin aktivitet.

FAZA E TRETË: MIRATIMI I PLANIT VJETOR TË AKTIVITETEVE NGA GRUPI KËSHILLIMOR SHQK

Miratimi i Planit Vjetor të aktiviteteve SHQK realizohet në takimin e rradhës së Grupit Këshillimor, ku diskutohet më gjerësisht mbi aktivitetet e paraqitura në plan, duke marrë në konsideratë kontekstin vendor. Kjo fazë inkurajon të gjithë pjesëmarrësit e Grupit Këshillimor të ndajnë sugjerimet e tyre rreth aktiviteteve që transformojnë shkollën e synuar në qendër komunitare me qëllim që të nxisin zhvillimin e të rinjve dhe mirëqenien e komunitetit. Aktivitetet përfshihen

në Planin Vjetor të Shkollës Qendër Komunitare, sipas përparësive të përcaktuara nga vetë palët e interesit. Aktorët vendorë duhet të inkurajohen të planifikojnë aktivitete mujore dhe të përcaktojnë aktorin përgjegjës për secilin aktivitet. Këto aktivitete do duhet të kryhen nga vetë institucionet përkatëse me synim rritjen e bashkëpunimit dhe përmirësimin e komunikimit ndërmjet palëve të interesit. Disa shembuj aktiviteteve përfshijnë biseda/takime diskutimi, aktivitete ndërgjegjësuese, takime ndërmjet palëve vendorë të interesit, trajnime specifike, diskutime letrare, aktivitete të përbashkëta sportive, si dhe aktivitete artistike ose kulturore. Koordinatorët SHQK monitorojnë dhe sigurojnë zbatimin e këtyre aktiviteteve.

Zbatimi i Planit Vjetor të Aktiviteteve SHQK, bazuar në kontekstin vendor të secilit komunitet dhe në aktivitetet e dakordësuara nga Grupi Këshillimor, fillon menjëherë pas miratimit të tij. Shkolla merr rolin organizator në realizimin e aktiviteteve me mbështetjen dhe angazhimin e të gjithë aktorëve vendorë të përfshirë në qasjen shumaktoriale SHQK për komunitete të qëndrueshme.

vizioni për

QASJA SHUMAKTORIALE VENDORE PËR KOMUNITETE TË QËNDRUESHME përbën një instrument të rëndësishëm në forcimin e komuniteteve vendore përmes fuqizimit të të rinjve, zhvillimit të komuniteteve, nxitjes së qytetarisë aktive dhe forcimit të sigurisë dhe demokracisë vendore.

Kjo qasje synon ta kthejë shkollën dhe aktorët rreth saj në agjentë ndryshimi pozitiv në komunitet dhe ta shndërrojë shkollën në vendin ku ndërtohet e ardhmja, përmes një partneriteti horizontal të institucioneve me nxënësit, familjen, grupet rinore, komunitetet fetare, dhe grupet e interesit. Kjo i bën institucionet e përfshira të jenë nxitës të kohezionit social dhe fuqizimit të të rinjve, nxitës të qytetarisë aktive dhe mbështetës të zhvillimit të komuniteteve më të sigurta.

Duke kthyer shkollën dhe të rinjtë në faktorë ndryshimi, kjo qasje, veçanërisht në bashki të mesme dhe të vogla, shndërrohet në një shtysë për forcimin e demokracisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrje. Për më tepër, angazhimi i përbashkët i të gjithë aktorëve, duke ndarë përgjegjësitë midis palëve në nivel vendor, krijon më shumë besim dhe më shumë mundësi për të realizuar një axhendë plotësimi për komunitetet vendore.

Ky realitet i ri që synohet përmes modelit SHQK si qasje shumaktoriale vendore, bëhet një



n të

ardhmen

domosdoshmëri në një kohë kur të rinjtë përballen me një sërë sfidash të sigurisë në vend, si ekstremizmi i dhunshëm, përdorimi i drogës, përfshirja në krimin e organizuar, apo qoftë dhe largimi i tyre nga vendi. Qasja shumëaktoriale nxit institucionet për marrjen e përgjegjësi në rritjen e qëndrësës së komuniteteve vendore. Kjo qasje synon të adresojë edhe faktorët që nxisin cenueshmërinë komunitare, duke forcuar ndjenjën e përkatësisë në komunitet, duke reduktuar dhunën, bullizmin, diskriminimin, pabarazinë, si dhe duke përmirësuar shëndetin emocional dhe psikologjik të të rinjve. Si pjesë e bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin, shkollat kthehen në një themel të fortë që kontribuon në mirëqenien e të rinjve, familjeve dhe komuniteteve.

Zbatimi i ideve dhe përvojave të paraqitura në këtë botim është plotësisht i mundshëm. Siç vërtetohet edhe nga përvoja e deritanishme, aktorët e përfshirë në zbatimin e modelit SHQK si qasje shumëaktoriale në të gjithë vendin, përfshirë institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe zbatimit të ligjit, janë shprehur të gatshëm për të zbatuar qasjen shumëaktoriale SHQK.

Zbatimi i modelit Shkolla Qendër Komunitare si një qasje shumëaktoriale vendore nuk mund të ketë sukses kur aktorët e përfshirë sforcohen për ta zbatuar atë, por kur secili institucion dhe aktor vendor i përfshirë, e ndan këtë vizion dhe dëshmon udhëheqje në zbatimin e tij.



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim – IDM është një organizatë joqeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.



[/company/idm-albania](https://www.linkedin.com/company/idm-albania)



<http://www.idmalbania.org/>



[/idm_albania](https://twitter.com/idm_albania)



[/IDMAlbania](https://www.facebook.com/IDMAlbania)

Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1, 1017, Tirana | T +355 4 240 0241 | info@idmalbania.org



**Shkolla
Qendër
Komunitare**

PËR KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

WEB: WWW.SHKOLLAIME.ORG

FACEBOOK: [@SHKOLLAIME.SHQK](https://www.facebook.com/@SHKOLLAIME.SHQK)

INSTAGRAM: [@SHKOLLAIME.SHQK](https://www.instagram.com/@SHKOLLAIME.SHQK)

